



VENDIMI ESHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ / UROSEVAC

## NË EMËR TË POPULLIT

Më  
Dita  
19.09.2017

19.09.2017

P.nr.120/15

## GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PER KRIME

TE RENDA-si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren individuale Hysnije Gashi si dhe me zyrtaren ligjore Albana Ujupi, në lenden penale kundër të akuzuarit [REDACTED] me vendbanim në Ferizaj, për shkak të veprës penale: lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.I.nr. 56-1/14 të datës 29 janar 2015, në prani te Prokurorit te shtetit Ismet Rrahmani të akuzuarit [REDACTED] si dhe të dëmtuarës [REDACTED], pas mbajtjes se shqyrtimit gjyqësor me dt. 10.03.2017, mori dhe publikisht shpalli kurse me datë 17.03.2017 përpiloi këtë:

## AKT GJYKIM

I akuzuari: [REDACTED] i lindur me dt. [REDACTED] ne [REDACTED] nga i ati [REDACTED] dhe e ema [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED] me vendbanim ne Ferizaj rr. "V. [REDACTED]" ka të ka te kryer fakultetin, i pa martuar, prind i dy fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës.

## ËSHTE FAJTOR

Sepse me datën 23.12.2013, në shtëpinë e tij në rrugën "V. [REDACTED]" në Ferizaj, per shkake te një mosmarrëveshje me bashkëshorten e tij [REDACTED], ashtu qe i pandehuri se bashku me prindërit e tij donte te shkonte ne një ndejë tek familjaret e tij, ndërsa dëshironte ta merrte me vete vajzën e përbashkët te tyre, e dëmtuara [REDACTED] e kishte refuzuar shkuarjen e vajzës, me pas [REDACTED] ishte nervozuar dhe e kishte goditur atë ne koke, duke e përplasur per muri, me ç'rast e dëmtuara pëson lëndime te lehta trupore.

-me të cilën kreu veprën penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartëekur dhe neneve 4,7,17,21,49,50,51 të KPRK-së të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin e

**GJYKON  
DËNIM ME KUSHT**

*Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afatin prej një viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale (koha e verifikimit).*

- *E dëmtuara [REDACTED] per realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontestin civil.*
- *Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ /pesëdhjete euro /, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, si dhe shpenzimet e procedurës ne shumën prej 20€ te nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.*

**Arsyetime**

**1. Historiku i procedurës**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka paraqitur aktakuzën PP/I.nr.56-1/14 të datës 29.01.2015 kundër të akuzuarit [REDACTED] për shkak të veprës penale : lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj- Departamenti i përgjithshëm, Divizioni penal, duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 10.03.2017, në të cilat fazë i akuzuari u deklarua i pafajshëm, për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK-së.

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare, ka mbetur pranë akuzës ndaj të akuzuarit, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK-së. Ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nga provat te cilat do te administrohen e sidomos

nga dëshmia e dëshmitares – te dëmtuarës si dhe provat te tjera te cilat gjinden ne shkresat e lendes, mendimi i ekspertit te mjekësisë ligjore do te vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale te përshkruar si ne dispozitiv te aktakuzës, duke i kërkuar gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënim i përkthyer në këto vepra penale.

## **2. Mbrojtja e të akuzuarit**

I akuzuari në shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK-së

I njëjti ka deklaruar se e shfrytëzon te drejtën për te u mbrojtur ne heshtje mbes pranë deklaratës se dhënë ne stacionin policor me date 26.12.2013.ku ka deklaruar me te dëmtarë eshtë martuar ne vitin 2000 dhe nga ajo martese ka dy fëmijësa i përket ditës kritike ka deklaruar se me të dëmtaren ka pas një mosmarrëveshje dhe se e ka shtyre ish bashkëshorten e tij por mohon faktin se e ka goditur në kokë duke e përplasur përmuri.

## **3. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Pasi që i akuzuari, nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK-së, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njërin me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- Nga dëshmia e dëshmitares- te dëmtuarës [REDACTED];
- nga përbajtja e raportit të Qendrës Emergjente ne Ferizaj të datës 24.12.2013 si dhe raportit te ekspertit mjeko- ligjor [REDACTED] i datës 29.12.2013.

## **4.Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Fillimisht Gjykata vlerëson si të pakontestueshme dhe të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Se me datën 23.12.2013,në shtëpinë e tij në rrugën “████████” në Ferizaj, per shkake te një mosmarrëveshje me bashkëshorten e tij ████████ ashtu qe i pandehuri se bashku me prindërit e tij donte te shkonte ne një ndeje tek familjaret e tij, ndërsa dëshironte ta merrte me vete vajzën e përbashkët te tyre, e dëmtuara ████████ e kishte refuzuar shkuarjen e vajzës, me pas ████████ ishte nervozuar dhe e kishte goditur ate ne koke, duke e përplasur per muri, me ç'rast e dëmtuara pëson lëndime te lehta trupore.

Gjykata gjendjen faktike e vërtetoi ne duke u bazuar Nga dëshmia e dëshmitares-████████ nga përbajtja e raportit të Qendrës Emergjente ne Ferizaj të datës 24.12.2013 si dhe raportit te ekspertit mjeko- ligjor ████████ i datës 29.12.2013.te cilat gjenden ne shkresat e lendes vërtetoi gjendjen e fakteve si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

### **5.Vlerësimi i tezës së mbrojtësit të akuzuarit**

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit, av. ████████ të paraqitur në fjalën përfundimtare, i cili ka kërkuar lirimin nga akuza duke pretenduar se per veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK-së prokuroria nuk ka ofruar prova te mjaftueshme per te mbështetur pretendimet e saj, Prokuroria ka mbështetur aktakuzën nga deklarata e “te dëmtuarës” ████████ e cila e kishte denoncuar bashkëshortin e saj jashtëmartesore se kinse i njëjti ka ushtruar dhune ndaj saj”, po ashtu edhe nga deklarata e ekspertit mjeko- ligjore ████████ i cili kishte kryer një ekspertize ne baze te kérkesës se prokurorit te çështjes.

Mbrojta konsideron se prokuroria nuk ka ofruar prova te mjaftueshme per te mbështetur pretendimet e saj ne rastin konkret kemi 2 prova dhe atë deklaratat e palëve te dëmtuarës dhe te akuzuarit si dhe nje prove e cila është marre me vonese ne rrithana te pasqaruara dhe jo bindëse ( arsyetimi i te dëmtuarës lidhur me paraqitjen e saj te mjeku pas ngjarjes).

Gjykata nuk duhet t’ia fale besimin ekspertizës mjeko- ligjore, me që e njëjta është marre ne mënyrë jo te rregullt dhe po ashtu e njëjta është jo serioze sepse vlerësimet kane ardhur nga dy raporte mjekësore te dorëzuara ne polici një dite me vonese, ndërsa ekspertiza mjeko ligjore eshte përpiluar shume me vone dhe e njëjta është bere pa ekzaminimin personal te pacientit.

Por Gjykata vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit janë të paqëndrueshme, ne baze te te gjitha provave te rastit , dhe ata mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko –ligjor Dr.N. [REDAKTUE] i datës 29.12.2014 vërtetohen dëmtimet Ndrydhje dhe përdredhje te unazave të qafës e që këto lëndime janë shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë, mbrejtës(jo te mprehte cilat janë kualifikuar si dëmtime te lehta trupore, me pasoja të përkohshme të shëndetit, shkresave te cilat gjenden ne dosjen e lendes te deklarimeve te dëshmitares – te dëmtuarës ka vërtetuar gjendjen faktike si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi. Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se ne veprimet e te akuzuarit manifestohen te gjitha tiparet e veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par.1 nenpar 1.4 te KPK-es.

#### **6. Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit**

Gjykata vlerëson se në veprimet e të akuzuarit, janë plotësuar të gjitha elementet qenësore të figurës së veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPK-së.

#### **7. Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-ës rrethanë lehtësuese nuk gjeti, ndërsa si rrethane renduese mospranimin e fajësisë edhe përkundër provave te qarta materiale.

Gjykata është e bindur se me anë të këtij dënimi është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimive i paraparë në nenin 41 të KPK-ës, dhe me këtë dënim që është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, rrethanat dhe mënyrën e kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit, se me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përbaj personat e tjera nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale), se përmes këtij dënimi do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### **8.Shpenzimet procedurale**

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, Gjykata obligoi të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor. Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ /njezet euro/, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, si dhe shpenzimet e procedurës ne shumën prej 20€ te nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

P.nr.120/15 dt. 17.03.2017

Sekretare juridike

Gjyqtari,

Albana Ujupi

Hysnije Gashi



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes kësaj Gjykate.